

Shoqëria : ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K.
Selia: Rr.Sami Frashëri , Pallati Bjorn, Kati 11-të , Tirane
Data e themelimit: 03 Mars 2006
NIPTI: K61814023M

**VENDIM NR.2 DATË 09 NËNTOR 2020
I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

Sot më datë 09.11.2020 , ortakët e shoqërisë “ ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS ” sh.p.k., në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë , pasi shqyrtuan raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë:

VENDOSËN:

1. Të pranojnë raportin e Audituesit Ligjor Znj. Enkelejda Alite për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë nga 20,100,000 leke ne 10,050,000 leke.
2. Të pranojnë kapitalin e zvogëluar të shoqërisë në vlerën 10,050,000 leke e ndarë me kontributin e ortakëve si më poshtë:

Olset Haxhiu 10,050,000 leke (zotërues 100 % të pjesëve të kapitalit)

Asambleja e ortakëve

Olset HAXHIU

Olset Haxhiu



Blenard DURMISHI

Blenard Durmishi



Shoqëria : ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K.
Selia: Rr.Sami Frashëri, Pallati Bjorn, Kati 11-të , Tirane
Data e themelimit: 03 Mars 2006
NIPTI: K61814023M

**VENDIM NR.1 DATË 30 TETOR 2020
I ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

Sot më datë 30 Tetor 2020, ortakët e shoqërisë “**Illyrian Consulting Engineers**” sh.p.k. në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të Aktit të Themelimit dhe të Statutit të Shoqërisë:

VENDOSËN:

1. Të fillojnë procedurat ligjore për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë në shumën 10.050.000 leke, për rrjedhojë kapitali shkon nga shuma 20.100.000 leke në shumën 10.050.000 leke. Ky zvogëlim i kapitalit behet për arsye se Z.Blenard Durmishi, zotërues 50% të pjesëve të kapitalit ka vendosur të largohet nga shoqëria me dëshirën e tij duke tërhequr kuotat e kapitalit fillestar për shumën 50.000 leke dhe kuotat e kapitalit të rritur nga fitimet e shoqërisë për shumën 10.000.000 leke ;
2. Të emërojë Znj.Enkelejda Alite, Ekspert Kontabël I Regjistruar, me Licence Nr.309 datë 28.03.2014 të përgatisë raportin dhe modalitetet e zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë;

Asambleja e ortakëve

Olset HAXHIU

Olset Haxhiu



Blenard DURMISHI

Blenard Durmishi



RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

Objekti I Misionit:

Zvogëlim i kapitalit themeltar të shoqërisë

“ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SH.P.K.

Eksperti Kontabël I Regjistruar

ENKELEJDA ALITE

Tirane , me 07 NENTOR 2020

R A P O R T

Për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SH.P.K.

Në cilësinë time si Ekspert Kontabël i Regjistruar i shoqërisë suaj dhe në zbatim të misionit të parashikuar nga neni 150 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ju paraqes raportin tim mbi projektin për zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë suaj në shumën 10,050,000 leke, operacion për të cilin ka vendosur mbledhja e ortakëve të shoqërisë me Vendim nr.1 datë 30/10/2020.

Unë kam proceduar në kontrollin e informacioneve të dhëna nga shoqëria për motivet e zvogëlimit të kapitalit dhe mënyrat e realizimit të tij.

Kam verifikuar gjithashtu , informacionet e shifruara që janë paraqitur duke kryer hapat që i cmova të nevojshme sipas normave të profesionit. Informacionet e shifruara të paraqitura nga shoqëria janë marrë nga bilancet e nxjerra nga shoqëria deri në vitin 2019 të cilat janë të audituara pasi shoqëria plotëson kushtet për auditim.

Shoqëria “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë nr. 35111 datë 03/03/2006 nga ortakët Z.Olset Haxhiu dhe Z. Blenard Durmishi të cilët zotërojnë secili nga 50% të pjesëve të kapitalit.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë në momentin e krijimit të saj ka qënë 100.000 leke. Më vonë ka ndryshuar si më poshtë:

Me numër cështje të QKB-së CN-684835-02-12, datë 22.02.2012 është bërë një zmadhim i kapitalit të shoqërisë nga fitimi i vitit 2010 në shumën 20,000,000 leke duke e çuar vlerën e kapitalit të shoqërisë nga 100.000 leke në shumën 20,100,000 leke, me numër të përgjithshëm 20,100 të kuotave të kapitalit. Kështu aktualisht sipas ekstraktit të QKB-së Z. Olset Haxhiu është ortak me pjesëmarrje 50% të pjesëve të kapitalit ose në vlerë për shumën 10,050,000 leke dhe Z.Blenard Durmishi është ortak me pjesëmarrje 50% të pjesëve të kapitalit ose në vlerë për shumën 10,050,000 leke.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është :

Studim, planifikim urbanistik, projektim, mbikqyrje, kolaudim në fushën e ndërtimit, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe investimin për realizimin me fonde publike dhe jopublike të veprave publike ose private si: ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve dhe nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore dhe të gjitha veprave të tjera madhore, ujësjellesave, linjave mbitokësore dhe nëntokesore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujitëse, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike.

I. Motivet e zvogëlimit të kapitalit

- Largimi nga shoqëria me dëshirën e tij të Z.Blenard Durmishi, zotërues 50% të pjesëve të kapitalit.
- Zvogëlimi i kapitalit për arsye të tërheqjes së kuotave të kapitalit fillestar në shumën 50,000 leke si dhe kuotat e kapitalit të rritur nga fitimet e shoqërisë në shumën 10,000,000 leke.
- Për shumën e tërhequr do të paguhet tatimi i mbajtur në burim prej 15 % ose në shumën 1,500,000 leke në bazë të ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 35 “Mbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa”.

II Vlera e zvogëlimit dhe mënyrat e rritjes e të zvogëlimit të kapitalit

Kapitali themeltar propozohet të arrije në vlerën 10,050,000 leke nga të cilat:

- | | | |
|---|-------------------|-----------------------------|
| - | 100,000 leke | kapitali i neneshkruar |
| - | 20,000,000 leke | shtesë kapitali viti 2012 |
| - | (10,050,000) leke | zvogëlim kapitali viti 2020 |

Zvogëlimi i kapitalit do të realizohet nga kapitali i rritur në vitin 2012 nga fitimet e akumuluarra dhe të pashperndara deri në vitin 2010.

Përcaktimi i destinacionit të tërheqjes së kuotave nga Z.Blenard Durmishi të lidhur me zvogëlimin e kapitalit prej 10,050,000 leke është vendosur nga asambleja e ortakëve me vendimin nr.1 datë 30/10/2020. Gjithashtu do të bëhet edhe pagesa e tatimit të mbajtur në burim prej 15% ose në shumën 1,500,000 leke.

III. Përcaktimi i kuotave për secilin ortak

1- Në momentin e regjistrimit të saj pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me datë 03/03/2006, në themelimin e saj shoqëria ka pasur një kapital themeltar 100.000 leke

2- Me numër cështje të QKB-së CN-684835-02-12 kapitali i shoqërisë është rritur në shumën 20,000,000 leke dhe arrin shumën 20,100,000 leke.

3- Tërheqja e kuotave të kapitalit nga Z.Blenard Durmishi, do të zvogëlojë vlerën e kapitalit themeltar për shumën 10,050,000 leke, dhe kështu kapitali i shoqërisë arrin shumën 10,050,000 leke.

Pas zvogëlimit të kapitalit, kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k., në vlerën 10,050,000 leke është si më poshtë:

Emer mbiemer	Kontrib/fillestar	Kapital I rritur	Kontrib/total
Olset HAXHIU	50,000	10,000,000	10,050,000
SHUMA	50,000	10,000,000	10,050,000

OPINION

Duke pasur parasysh se unë kam përmbushur misionin tim për vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë bazuar në vlerat e bilancit datë 31.12.2019 vërtetoj se llogaritë kontabile të kësaj shoqërie për efekt të vlerësimit të tyre për zvogëlimin e kapitalit shprehin vlerën pasurore reale të shoqërisë që përfaqësohet nëpërmjet kapitalit të saj themeltar në vlerën 10,050,000 leke.

Nuk kam vërejtje lidhur me shkaqet dhe kushtet e këtij operacioni i cili do të zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë suaj nga 20,100,000 leke në 10,050,000 leke i përberë nga 10,050 pjesë me nga 1,000 leke kuota.

Tirane, me 07/11/2020

Enkelejda ALITE
AUDITUES LIGJOR
Licenca Nr. 309

